

INFORMACION PER FAQEN E INTERNETIT TE BKT-se BAZUAR MBI PARIMET E UDHËHEQJES SE KORPORATES

Përditësuar më 31 mars 2020

1. POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMIT

Mekanizmi i vendimmarrjes per shpërndarjen e fitimit tek Banka Kombëtare Tregtare ("BKT" ose "Banka") përbëhet nga rekomandimi i bere nga Keshilli Drejtues dhe miratimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve në BKT mbahet të paktën një herë në vit, duke synuar që të miratojë pasqyrat financiare të Bankës dhe të vendosë për shpërndarjen e fitimit te vitit te fundit financiar të mbyllur.

Bazuar në vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha fitimet e realizuara nga BKT gjatë viteve financiare 2000-2015 janë kapitalizuar dhe janë përdorur nga Banka për të mbeshtetur zmadhimin e vazhdueshëm të bilancit dhe për të rritur fitimin.

Më 30 mars 2017 Banka realizoi shpërndarjen e parë të dividendit tek Aksioneri i saj.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të BKT është zhvilluar dy herë përgjatë vitit 2019. Mbledhja e Përgjithshme datë 20 mars 2019, miratoi rezolutën Nr. 2 si më poshtë:

"Miratohen pasqyrat financiare statutore dhe SNRF të audituara nga "Grant Thornton" sh.p.k., për vitin financiar mbyllur më 31 dhjetor 2018".

Që sipas rekomandimit të Këshillit Drejtues, fitimi neto i vitit 2018; 7,427,178,647 Lekë të përdoret si më poshtë:

- a) Një pjesë e fitimit neto: 371,358,932 Lekë do të përdoret si rezervë ligjore bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- b) Një pjesë e fitimit neto: 1,485,435,729 Lekë do të përdoret për krijimin e rezervës së përgjithshme bazuar në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë No.69, datë 18.12.2014 "Pë kapitalin rregullator të Bankës";
- c) Një pjesë e fitimit neto të pashpërndarë të vitit 2018, në shumën në 3,863,300,000 Lekë ekuivalent në USD 35,000,000, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 110.38, do të përdoret për t'u shpërndarë si dividend tek Çalik Finansal Hizmetler A.S., si aksioner i vetëm i BKT. Kjo shumë do të paguhet në datën 19 Prill 2019.
- d) Pjesa e mbetur e fitimit neto: 1,707,083,986 Lekë do të mbahet si fitim i pashpërndarë.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të BKT datë 30 korrik 2019, miratoi rezolutën nr. 2, sipas të cilës "Grant Thornton" sh.p.k. emërohet si auditor i jashtëm i Bankës (Ekspert Kontabël i Autorizuar) për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2019.